

Aneksi 7

FTESË PËR OFERTË

Emri: Instituti për Politika Zhvillimore INDEP
Adresa: Rr. ‘Fehmi Agani’, Nr. 50 A/4
Kodi Postar 10000, Prishtinë, Kosovë
E-mail: office@indep.info
Afati i dorëzimit të ofertës: 31 maj 2024

Instituti për Politika Zhvillimore INDEP po zbaton projektin “*Të rinjtë për një të ardhme të qëndrueshme*” në kuadër të Programit Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Prendimor 2 (ReLOaD2), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), duke mbështetur komunat në zhvillimin e mekanizmave transparente të financimit për OSHC-të, në mënyrë që të përmirësojë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në komunitetin lokal.

Kushtet për pjesëmarrje:

Të gjithë subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese, më së largu deri më 31 maj 2024, në adresën e e-mailit: office@indep.info ose në adresën postare Rr. ‘Fehmi Agani’, Nr. 50 A/4, Kodi Postar 10000, Prishtinë, Kosovë. Ofertat e pranura pas këtij afati, konsiderohen të pavlefshme.

Specifikimet teknike:

Për këtë projekt, INDEP do të zhvillojë procedurën e prokurimit për produktin sipas përshkrimeve në tabelën e mëposhtme.

Nr	Përshkrimi i produktit	Ditë pune	Çmimi/njësi Me TVSH (ALL)
1.	Ekspert në Objektivin e Zhvillimit të Qendrueshëm nr 11 Qytete dhe Komunitete të Qëndrueshme	3	
	Totali		

Specifikime të përgjithshme teknike:

- Përgatit kurrikulen interaktive për shkollën verore që do të organizohet në Bashkinë Lushnjë sipas OZHQ të përcaktuar;
- Shkolla verore do të organizohet me pjesëmarrjen e 45 të rinjve, ekspertë dhe staf i organizatave zbatuese
- Kontribuon në përgatitjen e programit për shkollën verore, bazuar dhe në Udhëzuesin mbi OZHQ.
- Kontribuon në hartimin e një raporti përmbledhës pas ofrimit të shërbimit
- Realizon me sukses sesionet e shkollës verore dhe aktivitetet në natyrë në Lushnje sipas programit dhe bazuar në të nxënit jo-formal.
- Koordinohet dhe mbështet stafin e projektit dhe trajnuesit e tjerë në lehtësimin e sesioneve dhe aktiviteteve të ndryshme që do të zhvillohen përgjatë shkollës verore.
- Merr pjesë në aktivitetet që do të realizohen gjatë 3 ditëve të eventit.
- Kontribuon në hartimin e raportit përfundimtar të shkollës verore
- Eksperti do të jetë i angazhuar për ofrimin e shërbimit gjatë 3 ditëve të shkollës verore në periudhën **1 – 15 Korrik 2024**.
- Me Subjektin fitues do të lidhet nje kontrate.

Kushte të përgjithshme:

- 1) Eksperiencë në ofrimin e trajnimeve/workshopeve me të rinjtë në fushën e ekspertizës
- 2) Ekspertizë në planifikimin urban dhe zhvillimin qytetar
- 3) Njohuri të politikave dhe strategjive urbane
- 4) Njohuri dhe aftësi në përfshirjen dhe bashkëpunimin komunitar
- 5) Aftësi komunikimi dhe sensibilizimi
- 6) Edukim i lartë universitar
- 7) Preferohet person fizik që ushtrojnë ekspertizën e tyre në territorin e Komunës së Fushë Kosovës;
- 8) Eksperti në ofertën e paraqitur duhet të ketë të përfshirë të gjitha kostot teknike dhe logjistike (transport, dieta, etj)
- 9) Dorëzimi i ofertës do të bëhet vetëm nëpërmjet email office@indep.info brenda datës 6 prill 2024 ose në adresën postare Rr. 'Fehmi Agani', Nr. 50 A/4, Kodi Postar 10000, Prishtinë, Kosovë. **Nuk pranohen ofertat dorazi.**
- 10) Paga e subjektit/ personit fizik kryhet me transfertë bankare pas marrjes së shërbimit dhe lëshimit të faturës përkatëse.

Në ofertën e tij, ofertuesi duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit. Gjithashtu ofertuesit, krahas Ofertës financiare të plotësuar, e cila duhet të jetë në EURO, me TVSH të përfshirë në çmim, por gjithashtu edhe me vlerë pa TVSH, duhet të paraqesin edhe këto dokumenta:

- 1) CV ku të tregohen eksperiencat e mëparshme;

- 2) Çertifikatë Regjistrimi nga ARBK në rastin kur është subjekt, ose ID në rastin e personit fizik;
- 3) Ofertën financiare për produktin sipas tabelës më sipër;
- 4) Numrin e llogarisë bankare.

Operatori që ofron shërbimin me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën.